



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



**RIINVEST**  
INSTITUTI PËR HULUMTIME ZHVILLIMORE  
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH

# BAROMETRI I PROKURIMIT PUBLIK (X-INDEX)

Njësia matëse e prokurimit  
publik në Kosovë

PËR PERIUDHEN  
JANAR – DHJETOR  
2019

2020







**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



**RIINVEST**  
INSTITUTI PËR HULLIMTË ZHVILLIMORE  
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH

# KOMUNA TRANSPARENTE, EFEKTIVE DHE LLOGARIDHËNËSE NË KOSOVË INSTITUTI RIINVESTE

## BAROMETRI I PROKURIMIT PUBLIK (X-INDEX)

Njësia matëse e prokurimit  
publik në Kosovë

**PËR PERIUDHEN  
JANAR – DHJETOR  
2019**

2020

**Autorë:** Tringë Shkodra

**Redaktorë:** Alban Hashani

Ky raport u publikua nga Instituti Riinvest, marrëveshja numër G-Pri-003, lëshuar nga Programi Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM), një kontratë pesë-vjeçare e financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID, Nr. AID-167-C-17-00001, duke filluar nga Janari 2017.

Përmbajtja në këtë publikim, është në përgjegjësi të Institutit Riinvest dhe nuk pasqyron domosdo mendimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.





# PËRMBAJTJA

SHKURTESAT.....6

ABSTRAKTI.....7

HYRJE.....8

1. PËRMBLEDHJE.....10

2. ÇKA ËSHTË NJËSIA MATËSE E  
PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË?.....14

3. X-INDEX RESULTS.....15

4. REZULTATET NGA NËN- INDEKSET .....19

## NËN-INDEKSI 1:

PROKURIMI PUBLIK SI PJESEMARRËS NË  
TOTALIN E BLERJEVE TË KOMUNËS (X1) . 20

## NËN-INDEKSI 2:

KONTRAKTIMI KONKURRUES (X2) ..... 24

## NËN-INDEKSI 3:

SJELLJE E QËNDRUESHME (X3) ..... 28

## NËN-INDEKSI 4:

KONCENTRIMI I FITUESIT (X4) ..... 32

## NËN-INDEKSI 5:

PJESËMARRJA E OFRUESIT (X5) ..... 36

## NËN-INDEKSI 6:

MJETET PRO-KONKURRENCËS (X6) ..... 40

## NËN-INDEKSI 7:

SHKELJET LIGJORE (X7) ..... 44

## NËN-INDEKSI 8:

PROCESI I PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT  
(X8)..... 48

## NËN-INDEKSI 9:

AFATI KOHOR (X9)..... 52

5. METODOLOGJIA.....57

NDËRTIMI I INDIKATORËVE .....57

# SHKURTESAT

**ARBK**

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare

**BE**

Bashkimi European

**KRPP**

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

**NVM**

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

**OECD**

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

**OShP**

Organi Shqyrtues i Prokurimit

**PBB**

Produkti i Brendshëm Bruto

**PNpP**

Procedurë e Negociuar pa Publikim

# ABSTRAKT

*Ky studim paraqet gjetjet e x-indeksit – njësisë matëse të prokurimit publik- e cila mat dhe vlerëson performancën e komunave në prokurim publik, dhe e krahason atë me praktikën më të mira. Gjetjet janë të grupuara në tri kategori, duke u bazuar në madhësinë e komunave në mënyrë që të mundësohet një paraqitje sa më objektive. X-indeksi është i bazuar në një model statistikor që përmban 9 nën-indekse, të cilat vlerësojnë disa dimensione të prokurimit publik duke u fokusuar në fushën e transparencës, konkurrencës dhe mbikëqyrjes. Në mënyrë indirekte, matë efikasitetin e komunave dhe dobësinë potenciale ndaj korrupsionit në prokurimin publik. X-indeksi përfshin të gjitha 38 komunat e Kosovës dhe mbulon aktivitetet e tyre të prokurimit në periudhën janar-dhjetor 2018, duke përfshirë 2649 kontrata, që tejkalojnë vlerën 179 milionë euro. Indeksi është ndërtuar në bazë të kriterëve objektive. Të dhënat për ndërtimin e indeksit janë marrë nga platforma zyrtare e prokurimit elektronik 'e-prokurimi' dhe statistika të tjera zyrtare.*

Fjalët kyçe: prokurimi publik, transpareca, korrupsioni, efikasiteti, llogaridhëna, komunat, njësi matëse, x-indeksi.

Riinvest mbetet i përkushtuar në mënyrë aktive në përpjekjet avokuese për një sistem të shëndoshë të prokurimit publik, i cili promovon paanësinë, efikasitetin dhe minimizon korrupsionin dhe keqpërdorimin e parasë së taksapaguesve, dhe maksimizon përfitimet ekonomike dhe sociale të prokurimit publik. Riinvest falënderon projektin 'Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM)' të USAID, për mbështetjen e këtij hulumtimi dhe aktiviteteve të ndërlidhura, dhe për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm gjatë realizimit të këtij projekti. Po ashtu, Riinvest falënderon zyrtarët e nivelit qendror dhe lokal për bashkëpunimin e tyre gjatë implementimit të hulumtimit tonë. Riinvest falënderon të gjitha palët e përfshira në përgaditjen e këtij raporti për kontributin e tyre, ndërsa merr përgjegjësinë e vetme për gjetjet dhe përfundimet e raportit.

# HYRJE

Qëllimi i x-indeksit është të monitoroj dhe vlerësoj performancën e 38 komunave të Kosovës në prokurim publik, përmes një indeksi statistikor. Vlerësimi fokusohet në tri fusha kryesore: transparencë, konkurrenca dhe efikasiteti. Pavarësisht se është një tregues relativisht i fuqishëm statistikor, x-indeksi nuk mund të pasqyrojë të gjitha aspektet e prokurimit, sidomos kur është fjala për aspektet cilësore. Rezultati i x-indeksit i referohet autoriteteve kontraktuese vetëm sipas kriterëve objektive dhe të matshme. Duke qenë se ato përbëjnë shumicën e aspekteve të procesit të prokurimit, kjo është një mënyrë e paanshme për vlerësimin e prokurimit publik.

Prokurimi publik përbën afërsisht 10% të PBB-së së Kosovës.<sup>1</sup> Prej nga, rreth 90% e kontratave janë dhënë duke përdorur procedurë të hapur. Sidoqoftë, 99% e kontratave publike u dhanë sipas kriterit të çmimit më të ulët, dhe jo të cilësisë së çmimit siç përmendet në Direktivën e BE-së për prokurimin publik. Të gjitha autoritetet kontraktuese, si në nivelin qendror ashtu dhe në atë lokal duhet të përdorin sistemin e prokurimit elektronik për çdo lloj aktiviteti të prokurimit. Që nga janari 2019, paraqitja elektronike e ofertave është e detyrueshme për të gjitha llojet dhe vlerat e prokurimit, ndërkaq dorëzimi fizik nuk është më i lejueshëm. Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit mbetet veçanërisht i rëndësishëm për shkak të madhësisë së tyre relative në ekonomi.<sup>2</sup> Ky segment kërkon përmirësime të vazhdueshme me qëllim minimizimin e keqpërdorimit të parave të taksapaguesve si dhe korrigjimin e shtrembërimeve në treg. Sidoqoftë, përmirësimet në transparencë janë të dukshme. Përveç publikimit të të gjitha kontratave në platformën elektronike 'e-prokurimi', shumica e komunave tanimë publikojnë të gjitha kontratat e nënshkuara edhe në faqet e tyre të internetit. Kjo erdhi si rezultat i presionit të fortë të organizatave të shoqërisë civile për qeverisje të hapur dhe të përgjegjshme, dhe nga gatishmëria e kryetarëve të bashkive për të qenë në përputhje me këtë.

Për këtë qëllim, ky studim synon të hap një diskutim më të informuar mbi prokurimin publik bazuar në informacione objektive. Vlerësimi i rezultatit të x-indeksit varion nga 0 në 1,

ku 1 nënkupton se autoriteti kontraktues po kryen aktivitete të prokurimit publik kryesisht në përputhje me praktikën më të mira (d.m.th. një sjellje të mirë, siç përcaktohet nga institucionet ndërkombëtare). Një vlerësim i ulët i x-indeksit prej 0, nënkupton devijim nga praktikën më të mira. Autoriteti kontraktues me vlera të ulëta të x-indeksit (në krahasim me institucionet e ngjashme) nuk janë domosdoshmërisht më të korruptuara ose më pak efikase; rezultati i ulët tregon thjesht se ka më shumë hapsirë për praktika korruptive ose joefikase në procedurat e tyre – por nëse kjo mundësi është shfrytëzuar apo jo nuk mund të dëshmohet nga këto statistika. Në mënyrë që të ketë një paraqitje sa më objektive të rezultateve, komunat janë klasifikuar në tre grupe: të mëdha, të mesme dhe komunat e vogla. Klasifikimi i komunave është bazuar në buxhetin dhe numrin e punëtorëve të komunave.

Shigjetat e vogla pranë emrave të komunave ofrojnë një krahasim me rezultatin e komunës përkatëse mes vitit 2019 krahasuar me 2018. '↔' tregon se komuna ka renditje si vitin e kaluar, '↑' simbolizon një ngjitje në renditje nga viti i kaluar dhe '↓' simbolizon një rënie në renditje. Numri në kllapa, pranë shigjetës, tregon se për sa vende është ngritur ose ka ranë një komunë e caktuar në renditjen e saj në atë indeks ose nën-indeks të veçantë në raport me komunat e tjera.

Qëllimi afatgjatë i x-indeksit është që të shërbejë si një mjet edukativ, duke përdorur krahasime ilustruese për të identifikuar dobësitë e autoriteteve kontraktuese, si dhe për të përdorur rezultatet për të edukuar më mirë autoritetet kontraktuese në praktikën më të mira, dhe për ti motivuar ata të menaxhojnë më mirë fondet publike. Projekti është krijuar për të ngritur debat mbi praktikën e përshtatshme të prokurimit publik, për autoritetet kontraktuese, publikun dhe mediat.

Ky raport është i organizuar në 5 seksione: seksioni i parë, ofron një përmbledhje ekzekutive të raportit. Seksioni i dytë shpjegon shkurtimisht njësinë krahasuese për prokurim publik (x-indeks). Seksioni 3 paraqet rezultatet e indeksit të përgjithshëm për të gjitha komunat, ndërsa Seksioni 4 paraqet rezultatet nga secili nën-indeks individualisht. Seksioni 5 paraqet një përshkrim të hollësishëm të metodologjisë.

1 KRPP, 2019. Raporti mbi Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë për vitin 2018

2 KRPP, 2020.





**Qëllimi i x-indeksit është  
të monitoroj dhe vlerësoj  
performancën e 38 komunave  
të Kosovës në prokurim publik,  
përmes një indeksi statistikor.**

# 1

## PËRMbledhje

Ngjashëm si me vitin e kaluar, rezultati mesatar i indeksit të përbërë për të gjitha komunat është 0.70 pikë të indeksit. Përkatësisht, renditja ndërmjet nën-indekseve është përafërsisht e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Nga nëntë nën-indekset, gjetjet tregojnë se komunat kanë performuar më së miri në nën-indeksin “Prokurimi publik si pjesëmarrës në totalin e blerjeve të komunës (x1)”, me një rezultat mesatar prej 0.96 pikë të indeksit, rezultat ky i cili krahasuar me vitin 2018 është më i lartë. Ndërkohë, nën-indeksi ku komunat kanë performuar më së dobëti është “Mjetet Pro-konkurrencës (x6)”. Ky nën-indeks vlerëson se në çfarë mase komunat përdorin mjetet konkurruese, kryesisht përmes: ndarjes së kontratës në pjesë dhe vlerësimitin e kriterëve të dhënies së kontratës për nga kualiteti (dhe jo nga çmimi më i ulët). Për dallim nga viti i kaluar, disa përmirësime të vogla u evidentuan këtë vit në këtë nën-indeks. Edhe pse performanca e komunave për vitin 2019 në këtë nën-indeks është e dobët, gjetjet tona zbulojnë se komunat kanë përdorur mjetin konkurrues të ‘Ndarjes së kontratave në pjesë’ në 9% të rasteve, i cili është më i lartë krahasuar me 2018 (kur ishte me 7%). Ngjashëm me vitin

e kaluar, në 2019 në më shumë se 99% të rasteve, çmimi më i ulët ishte zgjedhur si kriter për dhënien e kontratës. Sipas raportit të komisionit Europian mbi vendin (2019), përdorimi i gjerë i kriterit me çmim më të ulët për dhënien e kontratave nuk është në përputhje me Direktivën e BE-së mbi prokurimin publik i cili promovon raportin më të mirë të cilësisë së çmimit.

Një tjetër nën-indeks në të cilin performanca e komunave është më e ulët se mesatarja e indeksit të përgjithshëm prej 0.70 pikë të indeksit është “Pjesëmarrja e ofertesit (x5)”. Rezultati mesatar për të gjitha komunat është 0.59 pikë të indeksit. Ngjashëm me “Mjetet Pro-konkurrencës (x6)”, ky nën-indeks është krijuar me qëllim të inkurajimit të komunave për të nxitur konkurrencën midis operatorëve ekonomik, dhe si rezultat, rritjen e cilësisë. Për këtë qëllim, ky nën-indeks mat numrin e tenderëve të pranuar për një thirrje të caktuar. Mesatarja e tenderëve të pranuar për një thirrje është 4.



## Ky nën-indeks


# vlerëson se në çfarë mase komunat përdorin mjetet konkurruese, kryesisht përmes: ndarjes së kontratës në pjesë dhe vlerësimin e kriterëve të dhënies së kontratës për nga kualiteti (dhe jo nga çmimi më i ulët)

Kur bie fjala te konkurrenca, “Afati kohor (x9)” është një tjetër nën-indeks i cili si synim ka që të nxisë konkurrencën duke inkurajuar komunat të mos përdorin procedurat e përsheptuara kohore. Rezultati mesatar i komunave në këtë nën-indeks është 0.62- një mesatare kjo e cila është nën rezultatin mesatar të x-indeksit prej 0.70 pikë të indeksit.

Njejtë si në vitin 2018, në raport me fushën e transparencës dhe konkurrencës, komunat kanë performuar më mirë në nën-indeksin “Konktraktimi konkurrues (x2)” me një rezultat të njejtë mesatar prej 0.82 pikë indeksi. Ky nën-indeks mat vlerën dhe numrin e kontratave me procedurë të negociuar pa publikim (PNpN), në raport me vlerën totale dhe numrin total të kontratave. Gjetje interesante vërehen në këtë nën-indeks; ku shohim se numri total i kontratave që u dhanë nga komunat përmes PNpN është 9%, që është më pak se vitin e kaluar ndërsa vlera totale e tyre është 4% (e cila krahasuar me 2018 është vlerë më e lartë).

Sa i përket efikasitetit, komunat përformuan shumë mirë në nën-indeksin “Sjellje e qëndrueshme (x3)”, me një mesatare prej 0.82 pikë të indeksit. Përgjatë një sistemi përlllogaritës, ky nën-indeks penalizon komunat që bëjnë anulimin ose përmisimin e kontratave, dhe e kundërta. Përqindja e njoftimeve të kontratave që janë ndryshuar qëndron në 12%, ndërsa ajo e atyre që janë anuluar në 16%.

Njoftimet për Dhënie të Kontratës, të publikuara në platformën elektronike ‘e-prokurimi’, të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik të Kosovës (KRPP) japin informacion të kufizuar në lidhje me kompanitë fituese, duke e bërë të vështirë identifikimin e kompanisë dhe pronarit. Kjo çështje, është e ndërlidhur me Agjencinë Kosovare të Regjistrimit të Biznesit (ARBK), pasi është e vështirë të gjurmohen këta operator ekonomik të regjistruar në ARBK, për shkak të ngjashmërisë së emrave të kompanisë që ata posedojnë.



**FIGURA 1. REZULTATET FINALE**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT

0.1

0.2

0.3

0.4

0.5

0.6

0.7

0.8

0.9

1.0

X-INDEX  
2019X-INDEX  
2018X-INDEX  
2019X-INDEX  
2018

Gllogoc

0.70

0.75

Ferizaj

0.67

0.68

Mamushë

0.70

0.72

Shtërpcë

0.66

0.73

Mitrovicë e Veriut

0.70

0.65

Zubin Potok

0.66

0.64

Prizren

0.69

0.74

Klllokot

0.65

0.69

Prishtinë

0.69

0.69

Junik

0.65

0.62

Gjilan

0.69

0.60

Leposaviq

0.65

0.59

Kamenicë

0.69

0.69

Graçanicë

0.63

0.75

Partesh

0.69

0.72

Shtime

0.63

0.63

Mitrovicë

0.68

0.69

Deçan

0.62

0.71

Viti

0.68

0.73

Zveçan

0.61

0.62

# 2

## ÇKA ËSHTË NJËSIA MATËSE E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË?

x-indeksi është njësi matëse e prokurimit publik, e cila është e ndërtuar mbi një model statistikor, bazuar në të dhëna sasiore të mbledhura nga platformat kryesore të prokurimit të Kosovës “e-prokurimi”. X-indeksi përdor të dhëna reale të qasshme për të matur shkallën e efikasitetit dhe konkurrencës të çdo autoriteti kontraktues (në këtë rast çdo komune) në prokurim publik, brenda një periudhë dymbëdhjetë mujore (janar-dhjetor 2018). Bazuar në një metodologji sasiore kërkimore, gjetjet lënë pak ose aspak hapësirë për interpretime subjektive. Pjesa më e madhe e të dhënave (90%), janë të qasshme dhe të grumbulluara në internet, përmes platformës së Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), të quajtur “e-prokurimi”. Burime të tjera të të dhënave përfshijnë OSHP (marrja e vendimeve bazuar në mbikqyrjen e ligjshmërisë së praktikave të prokurimit të autoriteteve kontraktuese); ARBK (Emri i operatorit ekonomik); dhe Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018. Projekti mbështetet kryesisht në metodologjinë e ngjashme, të zhvilluar në nivel ndërkombëtar dhe të përshtatur për kontekstin e Kosovës.

Qëllimi i përgjithshëm i “Njësisë matëse për prokurim publik- x-indeks”, është promovimi i qeverisjes të mirë dhe llogaridhënies sa i përket procesit të prokurimit në nivel komunal, me qëllim të luftimit të korrupsionit, duke nxjerrë në pah autoritetet kontraktuese shembullore dhe ato kontraverze, përmes një metodologjie kërkimore të bazuar në të dhëna faktike të prokurimit. Një rezultat i ulët në nën-indeksin e ‘x-indeksit’, nënkupton një devijim nga praktikatat më të mira të prokurimit. Komunitat me rezultate të ulëta vlerësimi nuk janë domosdoshmërisht të korruptuara, më pak efikase ose më pak të përgjegjshme. Megjithatë, një rezultat i ulët i ‘x-indeksit’ ngreh flamuj të kuq dhe lë më shumë hapësirë për shqetësim në lidhje me aktivitetin e prokurimit të komunave dhe procedurat e kryera, si në afëra të mundshme korruptive, ose ato të jo-efikasitetit. Po ashtu, rezultatet e ‘x-indeksit’, nuk synojnë dhe nuk mund të dëshmojnë afëra korruptive. Për shembull, një “Procedurë e Negociuar pa Publikim (PNpN)”, përdorimi i “Afatit kohor të përsheptuar” ose “Anulimi i Procedurës”, janë procedura të cilat janë pjesë e legjislacionit të Sistemit Kosovar të Prokurimit, dhe rekomandohet të përdoren në raste të caktuara. Megjithatë, një përdorim i shpeshtë i tyre, rezulton në një qeverisje më pak transparente, efikase dhe llogaridhënëse.



# 3

## REZULTATET E X-INDEKSIT

Për vitin 2019, nga kategoria e komunave të mëdha, siç vërehet në Figurën 2, me performancën më të mirë është komuna e Pejës me rezultat prej 0.75 pikë të indeksit- komunë e cila kërceu për katër vende më lartë krahasuar me vitin e kaluar, e ndjekur nga Gjakova (0.75 pikë të indeksit) dhe Podujeva (0.71 pikë të indeksit). Në anën tjetër, komuna me rezultatin më të ulët në këtë kategori komunash është Ferizaji me 0.67 pikë indeksi. Krahasuar me vitin e kaluar, në këtë vit në kategorinë e komunave të mëdha në këtë nën-indeks vërehen përmisime të vogla. Ndërkohë, komuna e Klinës prin listën në kategorinë e komunave të mesme, me një rezultat prej 0.76 pikë të indeksit. Kjo komunë kërceu për katër vende më lartë për t'u rradhitur e para. Komuna e Vushtrrisë (0.75 pikë të indeksit), Dragashit (0.74 pikë të indeksit), Malishevës (0.74 pikë të indeksit) dhe Rahovecit (0.76 pikë të indeksit) gjithashtu kanë performuar shumë mirë në këtë nën-indeks. Vitia dhe Deçani janë komunat me performancën më të dobët në këtë kategori komunash, me një rezultat prej 0.68 dhe 0.67 pikë të indeksit, respektivisht. Në kategorinë e tretë të komunave, apo komunat e vogla, prin Hani i Elezit me rezultat prej 0.82 pikë të indeksit- duke mbajtur pozitën e parë për dy vite rradhazi, i ndjekur nga komuna e Novobërdës me një rezultat prej 0.74 pikë indeksi. Në anën tjetër, në këtë kategori komuna e Zveçanit ka rezultatin më të ulët (0.61 pikë të indeksit).

Edhe këtë vit, rezultati mesatar i indeksit të përbërë për të gjitha komunat është 0.70 pikë indeksi. Pjesa më e madhe e komunave (21 komuna, ose 55%) kanë rezultat më të lartë se mesatarja. Sidoqoftë, një numër mjaft i madh i pjesës së mbetur të komunave (17 komuna, ose 45%), kanë rezultat më të ulët se mesatarja. Për dallim nga viti i kaluar, ku rangui

x-indeksit shtrihej nga 0.59 deri në 80 pikë të indeksit, këtë vit rangui varion nga 0.61 deri në 0.82 pikë të indeksit.

Nëse shikojmë rezultatin mesatar për të tri kategoritë e komunave, vërejmë se edhe këtë vit komunat e mesme kanë performuar më së miri me një mesatare të rezultatis të indeksit prej 0.72 pikë indeksi. Ndërkaq, për dallim nga 2018, komunat e mëdha kanë performuar me një mesatare më të lartë të x-indeksit nga 0.69 në 0.71 pikë të indeksit. Ndërsa rezultati mesatar për komunat e vogla vazhdon të jetë i njëjtë. (0.68 pikë të indeksit).

Ngjashëm me vitin e kaluar, nga nëntë nën-indekse, në 4 (ose 44%) prej tyre komunat bashkarisht kanë performancë më të ulët sesa mesatarja e indeksit të përgjithshëm. Kjo përfshin nën-indeksat vijuese: Pjesëmarrja e ofertuesit (x5), Mjetet Pro-Konkurrencës (x6), Shkeljet Ligjore (x7), dhe Afati Kohor (x9). Rezultatet nga këto nën-indekse shtrihen prej 0.34 pikë të indeksit (Mjetet Pro-konkurrese) deri në 0.62 pikë të indeksit (Afati Kohor). Komunat shfaqën rezultat më të lartë se mesatarja në nën-indeksat: Prokurimi Publik si Pjesëmarrës në Totalin e Blerjeve të Komunës (x1), Kontraktimi Konkurrues (x2), Sjellja e Qëndrueshme (x3), Koncentrimi i fituesit (x4) dhe Procesi i planifikimit të prokurimit (x8). Rezultatet prej këtyre nën-indekseve shtrihen nga 0.74 pikë të indeksit (Procesi i planifikimit të prokurimit) deri në 0.95 pikë të indeksit (Prokurimi Publik si Pjesëmarrës në Totalin e Blerjeve të Komunës).

Rezultatet për të tri kategoritë e komunave janë paraqitur ne figurat në vazhdim.

0.1

0.2

0.3

0.4

0.5

0.6

0.7

0.8

0.9

1.0

**PEJË**

2019 2018

0.78 0.70

**GJAKOVË**

2019 2018

0.75 0.75

**PODUJEVË**

2019 2018

0.71 0.71

**PRIZREN**

2019 2018

0.69 0.74

**PRISHTINË**

2019 2018

0.69 0.69

**GJILAN**

2019 2018

0.69 0.60

**MITROVICË**

2019 2018

0.68 0.69

**FERIZAJ**

2019 2018

0.67 0.68

**MESATARJA**

2019 2018

0.71 0.69



**FIGURA 2. REZULTATET E PËRGJITHSHME TË X-INDEKSIT PËR KOMUNAT E MËDHA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT

**KOMUNAT E MËDHA**



### MESATARJA 2019 2018

0.71 0.69 ↓

FIGURA 3. REZULTATET E PËRGJITHSHME TË X-INDEKSIT PËR KOMUNAT E MESME

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT

## KOMUNAT E MESME



**FIGURA 4. REZULTATET E PËRGJITHSHME TË X-INDEKSIT PËR KOMUNAT E VOGLA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT

## KOMUNAT E VOGLA

### SI KALKULOHET X-INDEKSI?

NËNTË INDIKATORËT TË SHPJEGUAR MË POSHTË, KOMBINOHEN PËR TË PRODHUAR NJË VLERË TË VETME TË X-INDEKSIT, DUKE PËRDORUR NJË MESATARE TË PONDERUAR:

$$x_{index} = \frac{x_1 + x_2 + x_3 + x_4 + x_5 + x_6 + x_7 + x_8 + x_9}{9}$$

Ku X është vlera finale e x-indeksit, dhe x1 deri x9 janë vlerat e indikatorëve individual të numëruar sipas listës së mëposhtme (pason llogaritja e detajuar e indikatorëve). Secili prej indikatorëve është i shkallëzuar në mes 0 dhe 100 dhe kështu ata kanë peshë të barabartë.

4

**REZULTATET NGA  
NËN-INDEKSET**

# NËN-INDEKSI 1: PROKURIMI PUBLIK SI PJESËMARRËS NË TOTALIN E BLERJEVE TË KOMUNËS (X1)

Prokurimi publik si pjesëmarrës në totalin e blerjeve të komunës (x1), krahason vlerën e kontratave të publikuara në platformën “e-prokurimi”, në raport me vëllimin total të kostove operative të kontrollueshme të komunës. Në këtë model, kostot operative të kontrollueshme të cilat janë përfshirë janë: mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet kapitale. Pagat dhe mëditjet, subvencionet dhe transferet dhe shërbimet janë përjashtuar, pasi ato janë shpenzime që nuk menaxhohen nga komunat. Formula për llogaritjen e “prokurimit publik si pjesë e blerjeve totale” është si më poshtë:

$$x1 = \frac{\text{vlera e kontratave të prokurimit publik}}{\text{vlera e kostove operative të kontrollueshme}}$$


Kostot operacionale të kontrollueshme, janë të përkufizuara si shuma e kostove të caktuara të cilat varen nga menaxhmenti i autoritetit kontraktues, në këtë rast nga menaxhmenti i komunave. Në rastet kur një pjesë e madhe e shpenzimeve del përtej sistemit të prokurimit publik, nënkupton një ambient më pak transparent për autoritetin kontraktues, dhe më shumë hapsirë për vendime arbitrare. Prandaj, qëllimi i këtij treguesi është që të inkurajojë komunat të përdorin procedura më transparente të prokurimit publik si platformën “e-prokurimi”, dhe si rrjedhojë të krijojnë një proces më transparent.

Njëjtë sikur se vitin e kaluar, prokurimi publik si pjesëmarrës në totalin e blerjeve të komunës (x1), është nën-indeksi në të cilin të gjitha komunat kanë performuar më së miri. Rezultati mesatar për 38 komuna është 0.96 pikë indeksi. Nëse shikojmë rezultatin mesatar për të tri kategoritë e komunave, vërejmë se komunat e mesme kanë performuar

më së miri me një mesatare të rezultatit prej 0.99 pikë të indeksit- mesatare kjo, e cila është më e lartë për 0.02 pikë krahasuar me vitin 2018; të ndjekura nga komunat e mëdha me një mesatare të rezultatit prej 0.95 pikë të indeksit. Në anën tjetër, komunat e vogla kanë performuar me një mesatare prej 0.93 pikë të indeksit. Për dallim nga viti i kaluar, këtë vit komunat e mëdha kanë një mesatare më të lartë se sa komunat e vogla. Tabela në vijim paraqet performancën e komunave të mëdha në këtë nën-indikator. Krahasuar me vitin e kaluar, komuna e Ferizajit nuk është më në krye të tabelës, duke u radhitur kështu si e fundit, me një rezultat prej 0.69 pikë të indeksit. Komunat si ajo e Gjakovës, Mitrovicës, Gjilanit dhe Pejës udhëheqin në këtë kategori me rezultat maksimal 1. Siç mund t'a vërejmë edhe në figurën 5, Prizreni nuk radhitet më si komuna me rezultatin më të ulët, duke kërcyer për tre vende më lartë, për tu renditur si performuesi i pestë më i miri me rradhë në këtë nën-indeks.



## KOMUNAT E MËDHA



<b>MESATARJA</b>	2019	2018	↑
	0.95	0.90	

**FIGURA 5. PROKURIMI PUBLIK SI PJESËMARRËS NË TOTALIN E BLERJEVE TË KOMUNËS (X1) PËR KOMUNAT E MËDHA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT



Rezultatet e x-indeksit, nuk nënkuptojnë që procedurat e prokurimit të përdorura nga komunat janë ilegale. Është legjitime që kostot operative të kontrollueshme të tejkalojnë vlerën totale të kostove të publikuara në platformën 'e-prokurimi'. Megjithatë, sa më e lartë shuma e kostove operative të kontrollueshme dhe sa më e ulët ajo e shpezimeve të publikuara në platformën 'e-prokurimi', aq më e ulët transparenca.

0.1    0.2    0.3    0.4    0.5    0.6    0.7    0.8    0.9    1.0




## KOMUNAT E MESME

Ndërkohë, siç shihet në Figurën 6, mbi 70% e komunave të mesme (nga Deçani deri në Skenderaj) kanë shfaqur performancë të shkëlqyer, me rezultat maksimal prej 1 pikë indeksi. Në figurën më poshtë, vërejmë gjithashtu se përveç komunave si: Deçani, Dragashi, Glogoci, Kamenicë dhe Klina, pozita e komunave të tjera ka pësuar ndryshime por të vogla. Ndërsa komuna me performancën më të ulët në këtë kategori komunash për këtë vit, është ajo e Istogut, me një rezultat prej 0.93 pikë të indeksit. Krahasuar me vitin e kaluar, në këtë vit në kategorinë e komunave të mesme në këtë nën-indeks vërehen përmisime të vogla.



**FIGURA 6. PROKURIMI PUBLIK SI PJESEMARRËS NË TOTALIN E BLERJEVE TË KOMUNËS (X1) PËR KOMUNAT E MESME**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT




# KOMUNAT E VOGLA

Në anën tjetër, për dallim nga viti i kaluar, komunat e vogla kanë shfaqur performancë më të dobët në këtë nën-indeks. Tabela më poshtë, tregon se pozita e komunave ka ndryshuar përveç komunës së Hanit të Elezit dhe Junikut, të cilat arritën të ruajnë pozitën e njejtë. Çfarë bie në sy është komuna e Mamushës e cila ka rënë për nëntë vende, me rezultat nga 1.00 në 0.89 pikë të indeksit. Ndërkohë, komuna me rezultatin më të ulët në këtë kategori vazhdon të mbetet edhe për këtë vit komuna e Leposaviqit, por këtë vit me një rezultat më të lartë- prej 0.63 pikë të indeksit.

	X-INDEX 2019	X-INDEX 2018		X-INDEX 2019	X-INDEX 2018	
Hani i Elezit	1.00	1.00	↔	Graçanicë	0.94	0.95 ↑ (3)
Junik	1.00	1.00	↔	Zubin Potok	0.94	1.00 ↔
Obiliq	1.00	1.00	↑ (2)	Novobërdë	0.89	0.92 ↓ (3)
Partesh	1.00	1.00	↑ (2)	Mamushë	0.89	1.00 ↓ (9)
Ranillug	1.00	1.00	↑ (2)	Shtime	0.88	1.00 ↓ (4)
Shtërpcë	1.00	1.00	↑ (2)	Kllokot	0.78	0.94 ↓ (1)
Zveçan	1.00	0.72	↑ (4)	Leposaviq	0.63	0.54 ↑
Mitrovicë e Veriut	0.99	1.00	↓ (4)	<b>MESATARJA</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
				0.93	0.96	↓

**FIGURA 7. PROKURIMI PUBLIK SI PJESËMARRËS NË TOTALIN E BLERJEVE TË KOMUNËS (X1) PËR KOMUNAT E VOGLA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT



# NËN-INDEKSI 2: KONTRAKTIMI KONKURRUES(X2)


**Kontraktimi konkurrues (x2)** mat vlerën dhe numrin e kontratave me procedurë të negociuar pa publikim (PNnP), në raport me vlerën totale dhe numrin total të kontratave. Në mënyrë që të bëhet matja e vlerës dhe numrit të kontratave të dhëna, peshë e barabartë i është dhënë të dyjave (sic vërehet edhe në formulë). Vlera e ulët e këtij indikator tregon se komuna gjatë blerjeve përmes prokurimit publik e shfrytëzon në masë të konsiderueshme procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe anasjelltas. Formula për llogaritjen e indikatorit të "Kontraktimit Konkurrues", është si më poshtë:

$$x2 = \left\{ \left[ \left( 1 - \frac{\text{value of contracts awarded through NPwP}}{\text{total value of contracts}} \right) + \left( 1 - \frac{\text{number of contracts awarded through NPwP}}{\text{total number of contracts}} \right) \right] / 2 \right\}^4$$

Kontraktimi konkurrues (x2) është një nën-indeks i krijuar me qëllim të nxitjes së konkurrencës dhe transparencës midis komunave në prokurim publik. Ky nën-indeks mat vlerën dhe numrin e kontratave të tenderuara përmes Procedurave të Negociuara pa Publikim (PNpP), në raport me vlerën totale dhe numrin total të kontratave. Edhe pse Ligji i Kosovës për Prokurimin Publik rekomandon përdorimin e kësaj procedure në raste të veçanta, përdorimi më i shpeshtë i kësaj procedure nuk konsiderohet si praktikë e mirë sa i përket transparencës dhe konkurrencës, pasi që u mundëson komunave që të ftojnë vetëm një ose një numër të limituar të operatorëve ekonomik për të ofertuar për një thirrje apo tender të caktuar, duke dëmtuar kështu të dyja: si transparencën ashtu edhe konkurrencën. Prandaj, qëllimi i këtij nën-indeksi është që të parandalojë komunat nga negociimi i drejtëpërdrejtë me një apo me disa operatorë ekonomikë pa shpallje publike për tender, në mënyrë që t'i mbrojë ata që të jenë pre e korrupsionit, dhe potencialisht nga mos marrja e vlerës për paratë si pasojë e konkurrencës së kufizuar. Ngjashëm me vitin e kaluar, komunat në këtë nën-indeks kanë performuar shumë mirë me një rezultat mesatar prej 0.81 pikë të indeksit. Komunat e vogla kanë përdorur më pak procedurën e negociuar pa publikim, me një rezultat mesatar prej 0.89, të ndjekura nga komunat e mesme me rezultat prej 0.86 pikë të indeksit. Ndërkohë, këtë procedurë

më së shumti e kanë përdorur komunat e mëdha, në një masë edhe më të madhe se sa në vitin e kaluar, me një rezultat prej 0.68 pikë të indeksit. Figura 8, paraqet rezultatet për komunat e mëdha në këtë nën-indeks. Komuna e Mitrovicës mban pozitën e njëjtë edhe për këtë vit, si e para në këtë kategori, me rezultatin më të lartë prej 0.86 pikë të indeksit- rezultat ky, i cili krahasuar me vitin 2018 është më i ulët. Të gjeturat tregojnë se nga 50 kontrata, komuna e Mitrovicës ka pranuar vetëm 2 kontrata me procedurë të negociimit pa publikim; dhe në vlerë 3% të kontratave. Rezultate të ngjashme kanë renditur komunën e Gjakovës si të dytën në këtë kategori komunash. Nga 104 kontrata të pranuar, komuna e Gjakovës ka përdorur këtë procedurë vetëm 10 herë (ose 10% të rasteve), ndërsa në vlerë, 1% të kontratave. Ndërkohë, disa ndryshime të vogla të pozicioneve të komunave vërehen në këtë kategori. Për vitin 2019, komuna e Prishtinës dhe Ferizajit kanë rezultatin më të ulët prej 0.52 dhe 0.40 pikë të indeksit. Për shembull, komuna e Prishtinës nga 191 kontrata të pranuar, 39 (ose 20%) prej tyre i ka pranuar përmes procedurës së negociimit pa publikim; dhe në vlerë 10% të kontratave. Ngjashëm ka vepruar edhe komuna e Ferizajit, duke pranuar 27% të kontratave përmes PNpN; dhe në vlerë, 14% të kontratave. Për këtë vit, komunat e mëdha kanë performuar më dobët në këtë nën-indeks krahasuar me vitin 2018.

## KOMUNAT E MËDHA



**FIGURA 8. KONTRAKTIMI KONKURRUES (X2) PËR KOMUNAT E MËDHA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGINAL I AUTORIT



Rezultatet e x-indeksit nuk nënkuptojnë që procedurat e prokurimit të përdorura nga komunat janë ilegale. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, Procedura e Negociuar pa Publikim është njëra ndër gjashtë procedurat që duhet të përdoren gjatë aktiviteteve të prokurimit publik. Neni 35 i këtij Ligji, thotë se kjo procedurë rekomandohet të përdoret nga autoritetet kontraktuese në rastet kur për arsye specifike një kontratë duhet ti jepet një operatori ekonomik. Megjithatë, përdorimi i shpeshhtë i kësaj procedure, zvogëlon transparencën, dobëson konkurrencën, dhe ngrit flamuj të kuq për afera të mundshme korruptive.

0.1    0.2    0.3    0.4    0.5    0.6    0.7    0.8    0.9    1.0




## KOMUNAT E MESME

Siç shihet në figurën 9, nga kategoria e komunave të mesme, komuna e Malishevës dhe e Kaçanikut nuk e kanë përdorur procedurën e negociuar pa publikim në asnjë rast, prandaj dhe janë vlerësuar me notën maksimale, në vlerë prej 1 pike të indeksit. Në anën tjetër, komuna e Lipjanit e cila vitin e kaluar ishte komuna me performancën më të mire, ka rënë për dy vende më poshtë me rezultat mesatar prej 1.00 në 0.98 pikë të indeksit. Kjo nënkupton se kjo komunë ka përdorur këtë procedurë vetëm një herë, vlera e të cilës nuk ka shumë peshë për t'u llogaritur. Komunitat me performancën më të dobët në këtë nën-indeks janë Vitia (0.69 pikë të indeksit) dhe Kamenica (0.67). Kjo e fundit ka rënë për shtatë vende më poshtë, duke u renditur në fund të tabelës. Komuna e Vitisë ka përdorur procedurën PNP në 14% të rasteve (ose në 10 kontrata nga gjithsej 70); ndërsa komuna e Kamenicës në 16% të rasteve (ose në 9 kontrata nga gjithsej 58).



**FIGURA 9. KONTRAKTIMI KONKURRUES (X2) PËR KOMUNAT E MESME**


BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT






# KOMUNAT E VOGLA

Ngjashëm me vitin e kaluar, komunat e vogla kanë performuar më së miri në këtë nën-indeks, me një rezultat mesatar prej 0.89 pikë të indeksit. Siç shihet në Figurën 10, komuna e Hanit të Elezit ka arritur të ruaj pozitën e njejtë, përdërisa renditja e komunave të tjera ka ndryshuar. Çfarë bie në sy është komuna e Kllokotit, e cila ka rënë për nënte vende më poshtë me rezultat nga 1.00 në 0.81 pikë të indeksit, dhe komuna e Junikut e cila është ngritur për njëmbëdhjetë (11) vende për t'u renditur si performuesi i dytë më i mirë në këtë kategori komunash. Komunat nga Hani i Elezit deri te Zveçani (të renditura sipas alfabetit), janë vlerësuar me notën maksimale 1.00, duke nënkuptuar se këto komuna nuk kanë përdorur procedurën e negociuar pa publikim në asnjë rast. Ndërkaq, komuna me performancën më të dobët në këtë kategori edhe për këtë vit është komuna e Shtimes, me vlerë mesatare prej 0.53 pikë të indeksit, e cila gjithashtu ka numrin më të madh të kontratave të dhëna përmes procedurës së negociuar pa publikim prej 20%; dhe në vlerë prej 9%.



**FIGURA 10. KONTRAKTIMI KONKURRUES (X2) PËR KOMUNAT E VOGLA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT



# NËN-INDEKSI 3: SJELLJE E QËNDRUESHME (X3)

**Sjellje e qëndrueshme (x3)** ky indikator llogaritet në bazë të të gjitha njoftimeve të kontratave të lëshuara nga autoriteti përkatës kontraktues të marra nga 'e-prokurimi', ku një rezultat i jepet secilës kontratë. Për shembull, një rezultat prej 1 i jepet një kontratë pa asnjë korrigjim, përdërisa një rezultat minimal 0, i jepet kontratave të anuluar ose atyre me katër përmisime ose më shumë.

Vlera e indikatorit llogaritet si rezultat mesatar i autoritetit kontraktues për të gjitha kontratat e tij të publikuara, siç përshkruhet me formulën e mëposhtme:

$$x3 = \frac{\sum \text{rezultati i kontratës}}{\text{numrin e kontratave}}$$


Qëllimi i këtij indikator është që të përmisojë efikasitetin e zyrtarëve komunal të prokurimit gjatë përgaditjes së thirrjeve publike për tenderë. Ndryshimet apo anulimet e thirrjeve u shkaktojnë humbje të kohës komunës, si dhe operatorëve ekonomikë. Po ashtu, ndryshimet apo anulimet e shpeshta të tenderëve publikë zvogëlojnë autoritetin e komunës, dhe demotivojnë ofertuesit ekonomikë për aplikim në thirrjen e ardhshme. Për të adresuar këtë çështje, ky nën-indeks ndëshkon komunat që shpesh anulojnë ose ndryshojnë thirrjet dhe i shpërblen ato që e bëjnë të kundërtën; përmes një vlerësimi pikësh, sistemi i të cilës është i shpjeguar në metodologji.

Gjetjet tregojnë se ngjashëm si me vitin e kaluar, komunat e vogla kanë performuar më së miri në këtë nën-indeks me

një mesatare prej 0.83 pikë të indeksit. Kjo, për faktin se komunat e vogla kanë një numër më të vogël të aktiviteteve të prokurimit (d.m.th. numrit të kontratave). Në anën tjetër, komunat e mesme kanë performuar me një mesatare prej 0.82 pikë të indeksit, ndërsa komunat e mëdha me 0.81 pikë të indeksit.

Figura 11, paraqet rezultatet për komunat e mëdha. Siç mund të vërejmë, pozita e komunave si ajo e Pejës, Prishtinës, Ferizajit dhe Gjilanit është konsistente me vitin e kaluar, përdërisa komuna e Gjakovës është ngritur për pesë vende për t'u renditur si performuesi i dytë më i mirë në këtë kategori komunash. Komuna më jo-efikase në këtë nën-indeks dhe kategori është komuna e Gjilanit me një rezultat prej 0.72 pikë të indeksit.

# KOMUNAT E MËDHA



<b>MESATARJA</b>	2019	2018	
	0.81	0.83	↓

**FIGURA 11. SJELLJA E QËNDRUESHME (X3) PËR KOMUNAT E MËDHA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGINAL I AUTORIT



Rezultatet e x-indeksit nuk nënkuptojnë që procedurat e prokurimit të përdorura nga komunat janë ilegale. Anulimet dhe korrigjimet janë procedura të domosdoshme në shumë raste. Megjithatë, një përdorim i shpeshtë i tyre mund të rezultojë në ulje të efikasitetit.

0.1 0.2 0.3 0.4 0.5 0.6 0.7 0.8 0.9 1.0




## KOMUNAT E MESME

Figura 12, paraqet rezultatet për komunat e mesme. Renditja e komunave ka ndryshuar për dallim prej vitit të kaluar. Këtë vit, komunat si ajo e Malishevës (0.88 pikë të indeksit), Vitisë (0.88 pikë të indeksit), Vushtrrisë (0.86 pikë të indeksit), dhe Klinës (0.86 pikë të indeksit), kanë rezultat më të lartë se 0.80 pikë të indeksit, andaj radhiten si komunat më efikase në këtë kategori komunash. Ndërkohë, komunat si: Gllgoc (0.75 pikë të indeksit), Deçan (0.71 pikë të indeksit) dhe Lipjan (0.71 pikë të indeksit) renditen si më jo-efikaset.



**FIGURA 12. SJELLJA E QËNDRUESHME (X3) PËR KOMUNAT E MESME**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT




## KOMUNAT E VOGLA

Për këtë vit, komunat e vogla kanë performuar më dobët në këtë nën-indeks krahasuar me vitin 2018. Siç paraqitet në Figurën 13, komuna e Zubin Potokut (0.99 pikë të indeksit), Novobërdës (0.94 pikë të indeksit) dhe Mitrovicës të Veriut (0.93 pikë të indeksit), janë komunat më efikase në kategorinë e komunave të vogla. Rezultati i lartë, prej 0.99 pikë të indeksit, i komunës së Zubin Potokut në këtë nën-indeks vë nga fakti se nga 19 njoftime për kontratë, Zubin Potoku ka pasur 0 anulime dhe vetëm një ndryshim. Në ndërkohë, komuna më jo-efikase në këtë kategori është Zveçani me rezultat prej 0.76 pikë të indeksit.



**FIGURA 13. SJELLJA E QËNDRUESHME (X3) PËR KOMUNAT E VOGLA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT



# NËN-INDEKSI 4: KONCENTRIMI I FITUESIT(X4)

**Koncentrimi i fituesit (x4)** matet si vlera dhe numri i të gjitha kontratave të dhëna për cdo ofertues individual, pjesëtuar me vlerën totale dhe numrin total të të gjitha kontratave të dhëna nga autoriteti kontraktues; kjo llogaritje është bërë për secilin ofertues të suksesshëm dhe rezultatet janë përmbledhur. Formula për llogaritjet e këtij nën-indeksi është si më poshtë:

$$x4 = \left\{ \left[ 1 - \sum \left( \frac{\text{vlera e kontratave të dhëna secilit ofertues}}{\text{vlera totale e kontratave}} \right)^2 \right] + \left[ 1 - \sum \left( \frac{\text{numri i kontratave të dhëna secilit ofertues}}{\text{numri total i kontratave}} \right)^2 \right] \right\} / 2$$

Dhënia e një pjese të madhe të kontratave në duart e një operatori ekonomik të vetëm, ose në duart e një grupi të vogël operatorësh ekonomik nuk është praktikë e rekomandueshme, dhe devijon nga praktikat më të mira të përcaktuara nga OECD. Në fakt, një gjë e tillë (edhe pse jo domosdoshmërisht) mund të ngrit flamujt e kuq për afëra të mundshme korruptive. Përveç saj, dhënia e një pjese të madhe të kontratave (në vlerë ose numra) e dëmton gjithashtu edhe konkurrencën, pasi vetëm një i vetëm ose një grup i vogël operatorësh ekonomik janë përfitues të tyre. Prandaj, qëllimi i këtij treguesi është të shmang koncentrimin e kontratave të mëdha (në vlerë dhe numra) në duart e një individi të vetëm me qëllim të parandalimit të korrupsionit dhe nxitjes së konkurrencës.

Në përgjithësi, të gjitha komunat kanë performuar shumë mirë në këtë nën-indeks, me një rezultat mesatar prej 0.85 pikë të indeksit- e cila krahasuar me vitin e kaluar është më

e lartë. Komunat e mëdha dhe ato të mesme kanë performuar më mirë se sa komunat e vogla. Komunat e mëdha kanë performuar më së miri me një rezultat prej 0.92 pikë të indeksit, të ndjekura nga komunat e mesme (0.89 pikë të indeksit). Ndërkaq, komunat e vogla kanë performuar me një rezultat prej 0.73 pikë të indeksit.

Figura 14, paraqet rezultatet e komunave të mëdha në këtë nën-indeks. Komuna e Prishtinës (0.97 pikë të indeksit), Prizrenit (0.95 pikë të indeksit), Pejës (0.93 pikë të indeksit) dhe Gjakovës (0.91 pikë të indeksit), patën rezultat më të lartë në këtë nën-indeks. Kjo nënkupton që të gjithë këto komuna kanë shmangur praktikën e dhënies së kontratave (në vlerë dhe numër) për një numër të vogël të operatorëve ekonomikë. Gjithashtu, komunat në këtë nën-indeks kanë shfaqur ca përmisime krahasuar me vitin e kaluar për këtë kategori komunash.




## KOMUNAT E MËDHA



### PRISHTINË

2019	2018	
0.97	0.94	↑ (1)



### PRIZREN

2019	2018	
0.95	0.96	↓ (1)



### PEJË

2019	2018	
0.94	0.93	↔




### GJAKOVË

2019	2018	
0.91	0.91	↔



### PODUJEVË

2019	2018	
0.91	0.84	↑ (2)



### GJILAN

2019	2018	
0.90	0.91	↓ (1)



### FERIZAJ

2019	2018	
0.89	0.88	↓ (1)



### MITROVICË

2019	2018	
0.89	0.76	↔

MESATARJA	2019	2018	
	0.92	0.89	↑

FIGURE 14. KONCENTRIMI I FITUESIT (X4) PËR KOMUNAT E MËDHA

BURIMI: VLERËSIMI ORIGINAL I AUTORIT



Rezultatet e x-indeksit nuk nënkuptojnë që procedurat e prokurimit të përdorura nga komunat janë ilegale. Duke u bazuar në parimet e tregut të lirë, është vendim i autoritetit kontraktues që të ndaj të gjitha kontratat një grupi të vogël operatorësh ekonomikë, apo një grupi më të madh. Megjithatë, në rastet kur kontratat ndahen vetëm tek një apo një grup i vogël i operatorësh ekonomikë, konkurrenca dëmtohet dhe ngriten dyshime për korrupsion.

0.1 0.2 0.3 0.4 0.5 0.6 0.7 0.8 0.9 1.0


## KOMUNAT E MESME

Njësoj si komunat e mëdha, edhe komunat e mesme performuan shumë mirë në këtë nën-indeks me një rezultat mesatar prej 0.89 pikë të indeksit. Siç mund të shihet në Figurën 15, komunat nga Malisheva deri tek Glogovci, kanë rezultat më të lartë se 0.90 pikë indeksi; që nënkupton se këto komuna në përgjithësi kanë shmangur praktikën e dhënies së kontratave për një numër të vogël operatorësh ekonomikë.



**FIGURA 15. KONCENTRIMI I FITUESIT (X4) PËR KOMUNAT E MESMEE**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT




# KOMUNAT E VOGLA

Rezultati mesatar i komunave të vogla, prej 0.73 pikëve të indeksit në këtë nën-indeks, shpreh më së miri dallimin në performacë në mes të komunave të vogla, mesme dhe të mëdha; ku këto të fundit patën një rezultat mesatar prej 0.92 dhe 0.89 pikë të indeksit, respektivisht. Në tabelën më poshtë, vërejmë se renditja e komunave ka ndryshuar, përveç komunave si: Hani i Elezit, Mamusha dhe Kllokoti, të cilat arritën të ruajnë pozicionin e njejtë. Në krye të tabelës është komuna e Obiliqit, e cila u ngrit për pesë vende më lartë për t'u radhitur si e para. Ndërkohë, komuna e Mitrovicës Veriore është e radhitur si e fundit, me një rezultat prej 0.54 pikë të indeksit.

	X-INDEX 2019	X-INDEX 2018			X-INDEX 2019	X-INDEX 2018	
Obiliq	0.94	0.81	↑ (5)	Junik	0.67	0.50	↑ (4)
Shtime	0.89	0.71	↑ (8)	Leposaviq	0.67	0.49	↑ (4)
Hani i Elezit	0.88	0.85	↔	Zveçan	0.63	0.27	↑ (4)
Mamushë	0.88	0.83	↔	Kllokot	0.60	0.58	↔
Ranillug	0.86	0.80	↑ (2)	Shtërpcë	0.59	0.82	↓ (8)
Novobërdë	0.82	0.88	↓ (4)	Partesh	0.59	0.72	↓ (5)
Graçanicë	0.70	0.89	↓ (6)	Mitrovicë e Veriut	0.54	0.68	↓ (4)
Zubin Potok	0.67	0.76	↔	<b>MESATARJA</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>	
					0.73	0.71	↑

**FIGURA 16. KONCENTRIMI I FITUESIT (X4) PËR KOMUNAT E VOGLA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT



# NËN-INDEKSI 5: PJESËMARRJA E OFERTUESIT (X5)

**Pjesëmarrja e ofertuesit (x5)** llogaritet përmes një procesi dy hapësh.

Në hapin e parë, niveli i konkurrencës vlerësohet për secilën kontratë, ku nën-indikator "k" krahason numrin e tenderëve të dorëzuar për një thirrje të caktuar për tender, me mesataren e numrit të tenderëve për llojin e kontratës. Formula për llogaritjen e indikatorit të pjesshëm "k" është sic paraqitet më poshtë:

$$k = 0.5 + \frac{\text{tenderët e dorëzuar për kontrataë-mesatarja e tenderëve për llojin e kontratës (tenderët e dorëzuar)}}{\text{mesatarja e tenderëve për llojin e kontratës (tenderët e dorëzuar)}}$$

Hapi i dytë në llogaritjen tonë është llogaritja e indikatorit agregat si shumë e ponderuar e indikatorëve k në të gjitha kontratat e dhëna nga autoriteti përkatës kontraktues. Çmimi i dhënë i çdo kontrate përdoret si pesha e tij, me qëllim të theksimit të rezultateve të indikatorëve për kontratat më të mëdha.

$$x5 = \frac{\sum \text{vlera e kontratës} * k}{\text{vlera totale e kontratave}}$$

Ky nën-indeks është krijuar me qëllim që të rrisë konkurrencën duke i inkurajuar komunat të nxisin konkurrencën mes operatorëve ekonomikë. Kjo arrihet duke vlerësuar nivelin e konkurrueshmërisë të bazuar në numrin e tenderëve që dorëzohen për çdo thirrje për tender. Tashmë dihet se një numër më i lartë i ofertave apo tenderëve të pranuar për një thirrje të caktuar, nënkupton që ka më shumë konkurrencë, dhe si rezultat kualitet më të lartë për çmimin e ofruar. Me fjalë të tjera, qëllimi i këtij nën-indeksi është që të rrisë konkurrencën duke i inkurajuar zyrtarët e prokurimit të komunave që të shmangin gabimet si përgaditja e thirrjeve për tender me specifika dhe kritere që mund ti përmbush vetëm një grup i caktuar i ofertuesve, duke përjashtuar të tjerët. Për këtë arsye, ky nën-indeks krahason numrin e tenderëve të pranuar për një thirrje të caktuar, me mesataren e numrit të tenderëve të pranuar për llojin e kontratës. Në këtë model, llojet e kontratës që janë përfshirë në monitorim dhe vlerësim janë: Kontratë e Furnizimit, Kontratë e Shërbimeve dhe

Kontratë e Punës. Komunat nga të gjitha kategoritë nuk kanë performuar shumë mirë në këtë nën-indeks. Rezultati për të gjitha komunat në këtë nën-indeks është 0.55 pikë të indeksit, që është më i ulët se mesatarja e indeksit të përgjithshëm (0.70 pikë të indeksit) dhe më e ulët krahasuar me vitin 2018. Nëse shikojmë rezultatin mesatar për të tri kategoritë e komunave, vërejmë se komunat e mëdha kanë të performuar më së miri me rezultatin prej 0.67 pikë të indeksit; të ndjekura nga komunat e mesme me rezultat prej 0.59 pikë të indeksit. Ndërsa, komunat e vogla kanë performancë më të ulët, me një rezultat prej 0.38 pikë të indeksit. Nga komunat e mëdha, siç vërehet në Figurën 17, Gjakova (0.80 pikë të indeksit) dhe Ferizaj (0.74 pikë të indeksit), janë performuesit më të mirë në këtë nën-indeks, duke arritur kështu të ruajnë pozitën e njejtë. Të gjeturat tregojnë se këto dy komuna kishin numrin më të lartë të ofertave të pranuar për një thirrje. Nga ana tjetër, nga kategoria e komunave të mëdha, komuna e Prizrenit ka performancën më të ulët, me rezultat prej 0.52 pikë të indeksit.

## KOMUNAT E MËDHA



### GJAKOVË

2019	2018
0.80	0.88



### FERIZAJ

2019	2018
0.74	0.85



### PRISHTINË

2019	2018
0.73	0.74



### MITROVICË

2019	2018
0.67	0.48



### PODUJEVË

2019	2018
0.66	0.64



### PEJË

2019	2018
0.65	0.79



### GJILAN

2019	2018
0.63	0.60



### PRIZREN

2019	2018
0.52	0.70



### MESATARJA

2019	2018
0.67	0.71



FIGURA 17. PJSËMARRJA E OFERTUESIT (X5) PËR KOMUNAT E MËDHA

BURIMI: VLERËSIMI ORIGINAL I AUTORIT



Rezultatet e x-indeksit nuk nënkuptojnë që procedurat e prokurimit të përdorura nga komunat janë ilegale. Është legale dhe e pranueshme që autoritetet kontraktuese të pranojnë vetëm një ofertë për një tender. Megjithatë, sa më i ulët numri i ofertave, aq më e ulët konkurrenca dhe kualiteti i ofertës.

0.1 0.2 0.3 0.4 0.5 0.6 0.7 0.8 0.9 1.0


## KOMUNAT E MESME

Siç shihet në Figurën 18, komuna e Malishevës ka performancën më të mirë në këtë kategori, me një rezultat prej 0.82 pikë të indeksit; ndjekur nga komuna e Rahovecit, me rezultat prej 0.80 pikë të indeksit. Ndërkohë, komuna e Kamenicës është renditur e fundit në këtë kategori, me rezultat prej 0.29 pikë të indeksit



**FIGURA 18. PJESËMARRJA E OFERTUESIT (X5) PËR KOMUNAT E MESME**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT




# KOMUNAT E VOGLA

Rezultati i ulët i komunave të vogla prej 0.38 pikë të indeksit- rezultat ky, i cili krahasuar me vitin 2018 është edhe më i ulët (0.44 pikë të indeksit), tregon performancën e dobët të tyre në këtë nën-indeks, dhe ndryshimin në mes tyre dhe komunave të mesme dhe të mëdha për dy vite rradhazi. Rezultatet e paraqitura në Figurën 19, tregojnë se komuna me performancën më të mirë është Novobërda, me rezultatin prej 0.78 pikë të indeksit. Në anën tjetër, rezultate shqetësuese në këtë kategori janë ato të komunës së Zubin Potokut (0.01 pikë të indeksit), Zveçanit (0.03 pikë të indeksit), dhe Leposaviqit (0.04 pikë të indeksit). Numri mesatar i tenderëve të pranuar për një thirrje të caktuar është 1.



**FIGURA 19. PJESËMARRJA E OFERTUESIT (X5) PËR KOMUNAT E VOGLA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT



# NËN-INDEKSI 6: MJETET PRO- KONKURRENCËS (X6)

**Mjetet pro-konkurrencës (x6)** tregon se deri në çfarë mase autoriteti kontraktues përdorë mënyrat opsionale që ndikojnë në rritjen e konkurrencës në prokurim publik.

Formula në vazhdim përdoret për kalkulimin e këtij nën-indikatorit:

$$x6 = \left( \frac{4x(nr: i kontratave të ndara në pjesë + nr: i kontratave të cilat për kriter kanë kualitetin)}{2x nr: i kontratave} \right)^{1/2}$$

Qëllimi kryesor i këtij nën-indeksi është inkurajimi i komunave për të nxitur konkurrencën në prokurim publik, përmes mjeteve pro-konkurrese, të cilat janë opsionale dhe shumë efektive. Në këtë model, fokusi i përdorimit të këtyre mjeteve bie në numrin e kontratave që komunat i ndajnë në pjesë, dhe numrin e kontratave të cilat e përdorin kualitetin përpara çmimit si kriter për dhënie të kontratave. Ndarja e kontratës në pjesë, i mundëson autoriteteve kontraktuese që të sigurojnë konkurrencë të mjaftueshme për çdo element të prokurimit. Ky instrument, po ashtu lehtëson qasjen e NVM-ve në kontrata publike, pasi që zvogëlon kualifikimet e kërkuara, dhe ndan punët më të thjeshta nga ato më të ndërlikuara që mund të realizohen nga një grup më i gjerë i ofertuesve. Ndërkohë, vlerësimi i tenderëve jo vetëm nga çmimi më i ulët por edhe për nga kualiteti, ka për qëllim që të ngris konkurrencën mbi një luftë të thjeshtë për kualitetin dhe çmimin më të ulët.

Nga të gjithë nën-indeksat, komunat kanë performuar më dobët në këtë nën-indeks, me rezultat prej 0.34 pikë të indeksit - i cili krahasuar me vitin e kaluar është më i lartë.

Ky rezultat buron nga fakti që në 99% të rasteve, komunat përdorin kualitetin përpara çmimit si kriter gjatë dhënies së kontratave.

Ngjashëm me vitin e kaluar, komunat e mëdha kanë performancë më të mirë në këtë nën-indeks, me një rezultat mesatar prej 0.44 pikë të indeksit; të ndjekura nga komunat e mesme me një mesatare prej 0.39. Në ndërkohë, komunat e vogla kanë performancën më të dobët (0.18 pikë të indeksit) nga të tre kategoritë e komunave.

Figura 20, tregon se komuna me performancën më të mirë në këtë nën-indeks është Gjakova, me rezultatin prej 0.57 pikë të indeksit nga maksimumi 1.00, përderisa Komuna e Mitrovicës e cila në vitin 2018 ka qenë në krye të tabelës, këtë vit ka rënë për pesë vende më poshtë. Kjo nënkupton se kjo komunë ka përdorur mjetet pro-konkurrese më pak krahasuar me vitin e kaluar në këtë kategori komunash. Ndërkohë, në anën tjetër, komuna Podujevës (e cila ka arritur të ruaj pozitën e njejtë) dhe Pejës kanë përdorur më pak këto procedura, duke arritur një vlerësim prej 0.33 dhe 0.32 pikë të indeksit.



## KOMUNAT E MËDHA



### GJAKOVË

2019	2018	
0.57	0.56	↑ (1)



### PRISHTINË

2019	2018	
0.53	0.44	↑ (2)



### PEJË

2019	2018	
0.48	0.21	↑ (5)



### GJILAN

2019	2018	
0.45	0.45	↓ (1)



### FERIZAJ

2019	2018	
0.45	0.43	↔




### MITROVICË

2019	2018	
0.36	0.56	↓ (5)



### PODUJEVË

2019	2018	
0.33	0.25	↔



### PRIZREN

2019	2018	
0.32	0.35	↓ (2)

### MESATARJA

2019	2018	
0.44	0.41	↑

FIGURA 20. MJETET PRO-KOKURENCËS (X6) PËR KOMUNAT E MËDHA

BURIMI: VLERËSIMI ORIGINAL I AUTORIT



Rezultatet e x-indeksit nuk nënkuptojnë që procedurat e prokurimit të përdorura nga komunat janë ilegale. Ndarja e komunave në lote dhe vlerësimi i tenderëve nga kualiteti, janë të gjitha aktivitete që rrisin konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Edhe pse përdorimi i këtyre aktiviteteve nuk është i obligueshëm, megjithatë sa më i ulët rezultati në këtë nën-indikatorë, aq më ulët përpjekjet e autoritetit kontraktues për të ngritur konkurrencën.

0.1 0.2 0.3 0.4 0.5 0.6 0.7 0.8 0.9 1.0




## KOMUNAT E MESME

Nga komunat e mesme, Klinë dhe Istogu qëndrojnë më së miri. Siç mund të shihet në Figurën 21, të dy këto komuna kanë përdorur më së shumti këto mjete, me rezultat prej 0.74 dhe 0.71 pikë të indeksit, respektivisht. Të dy këto komuna, në asnjë rast, nuk e kanë përdorur kualitetin përpara çmimit si kriter gjatë dhënies së kontratave, megjithatë, 22% e kontratave të komunës së Klinës, dhe 35% e kontratave të komunës së Istogut, janë ndarë në pjesë. Në anën tjetër, komunat me performancën më të ulët (0.00) janë komuna e Skenderaj dhe Deçanit, duke nënkuptuar që këto komuna nuk kanë përdorur në asnjë rast ndonjë nga mjetet pro-konkurrese.



**FIGURA 21. MJETE PRO-KONKURENCËS (X6) PËR KOMUNAT E MESME**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT




# KOMUNAT E VOGLA

Ngjashëm me vitin e kaluar, komunat e vogla kanë performuar më dobët në këtë nën-indeks. Gati se 50% e tyre nuk kanë përdorur në asnjë rast ndonjë nga këto mjete pro-konkurrese. Siç shihet në Figurën 22, komunat nga Graçanica deri te Zubin Potoku si rezultat i mos përdorimit të këtyre aktiviteteve, janë vlerësuar me rezultatin minimal prej 0 pikë të indeksit. Çfarë bie në sy, është komuna e Zveçanit, e cila është ngritur për njëmbëdhjetë vende për t'u renditur si performuesi i katër më i miri në këtë kategori komunash. Në anën tjetër, Mamusha dhe Hani i Elezit, janë komunat që kanë nxitur konkurrencën më së shumti, me një rezultat prej 0.69 dhe 0.53 pikë të indeksit.



**FIGURA 22. MJETET PRO-KONKURENCËS (X6) PËR KOMUNAT E VOGLA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT



# NËN-INDEKSI 7: SHKELJET LIGJORE (X7)

**Shkeljet ligjore (x7)** ky indikator matet përmes numrit të shkeljeve ligjore gjatë procedurave të prokurimit nga ana e autoritetit kontraktues (komunës), të ndarë me numrin e njoftimeve për dhënie të kontratave nga komuna. Për të vlerësuar këtë indikator, shfletohen të gjitha vendimet e OSHP-së, ku fokusi vihet tek shkeljet ligjore të gjykuara nga OSHP-ja. Formula e përdorur për të llogaritur këtë indikator është si më poshtë:

$$x7 = 1 - \left( \frac{\text{numri i rasteve të shkeljeve ligjore gjatë procedurave të prokurimit publik}}{\text{numri i kontratave}} \right)^{1/4}$$


Ligjshmëria e vendimeve të prokurimit të marra nga autoritetet kontraktuese, dhe të pranuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), është kusht paraprak dhe i domosdoshëm jo vetëm për praktikën më të mira por edhe për ligjshmërinë dhe funksionalitetin e vetë vendimit. Vendimet e shpeshta të marra nga OSHP, në disfavor të autoritetit kontraktues, mund të vejnë në pikëpyetje autoritetin e komunës dhe vendimet e saj në sy të operatorëve ekonomik. Gjithashtu, një numër i shpeshtë i vendimeve të OSHP-së kundër komunave, ka ndikim negativë në efikasitetin e komunave gjatë procedurës së marrjes së vendimeve. Prandaj, nën-indeksi "Shkeljet ligjore (x7)", pasqyron numrin e shkeljeve të komunës, të gjykuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), organ ky i autorizuar për mbikqyrjen e ligjshmërisë së praktikave të prokurimit publik të autoriteteve kontraktuese.

Komunat nuk kanë performuar shumë mirë në këtë nën-indeks, me një rezultat mesatar prej 0.60 pikë të indeksit, që është më i ulët se mesatarja e indeksit të përgjithshëm (0.70 pikë të indeksit) dhe më i ulët krahasuar me rezultatin e arritur në vitin 2018. Njëjtë sikur vitin e kaluar, komunat e

vogla, kanë performuar më mirë se komunat e mëdha dhe të mesme, me një rezultat prej 0.76 pikë të indeksit; duke nënkuptuar se këto komuna kanë pasur një numër të vogël të shkeljeve ligjore të gjykuar nga OSHP. Komunat e mesme, kanë një rezultat prej 0.56 pikë të indeksit, ndërsa komunat e mëdha një rezultat prej 0.49 pikë të indeksit.

Nga komunat e mëdha, siç mund të shihet në Figurën 23, pozicioni i komunave ka pësuar ndryshime, megjithëse të vogla. Për vitin 2019, komuna e Pejës ka performuar më së miri, me një rezultat prej 0.68 pikë të indeksit; e ndjekur nga Podujeva me 0.60 pikë të indeksit. Në anën tjetër, komuna e Prishtinës është komuna me numrin më të madh të shkeljeve ligjore të gjykuar nga OSHP. Nga 164 njoftime për dhënie të kontratës sa ka pasur komuna, 33 prej tyre janë shpallur të pa-ligjshme nga OSHP-ja. Kjo është edhe arsyeja pse komuna e Prishtinës ka një rezultat të ulët në këtë nën-indeks, me 0.33 pikë të indeksit. Në ndërkohë, komuna e Gjilanit, e cila në vitin 2018 ishte renditur në fund të tabelës, këtë vit ka pasur përmisime ndonëse të vogla, duke u ngritur për një pozitë më lartë, me rezultat nga 0.29 në 0.38 pikë të indeksit.

## KOMUNAT E MËDHA



<b>MESATARJA</b>	2019	2018	↑
	0.49	0.48	

FIGURA 23. SHKELJET LIGJORE (X7) PËR KOMUNAT E MËDHA

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT



Rezultatet e x-indeksit nuk nënkuptojnë që procedurat e prokurimit të përdorura nga komunat janë ilegale. Një numër i shpeshtë i vendimeve të OSHP-së kundër komunave, ka ndikim negativ në efikasitetin e komunave dhe mund të ngrisë pyetje rreth aftësisë së zyrtarëve të prokurimit kur marrin vendime, të cilat gjykohen si shkelje ligjore nga OSHP-ja.

0.1 0.2 0.3 0.4 0.5 0.6 0.7 0.8 0.9 1.0



## KOMUNAT E MESME

Siç mund t'a vërejmë në figurën 24, përveç komunës së Klinës, pozita e të gjitha komunave të tjera ka ndryshuar. Çfarë bie në sy, janë komunat si ajo e Skenderaj (e cila u ngrit për tetë vende më lartë për t'u radhitur si e para), me një rezultat maksimal prej 1.00 pikë të indeksit, Fushë Kosovës (e cila kërceu për 11 vende më lartë dhe u rendit si performuesi i dytë më i mirë në 2019) me rezultat prej 0.58 pikë të indeksit, Deçanit dhe Vitisë (të dyja këto komuna janë ngritur për shtatë vende më lartë në raport me vitin e kaluar) me rezultat prej 0.61 dhe 0.58 pikë të indeksit, respektivisht. Në anën tjetër, komuna e Lipjanit ka rezultatin më të ulët në këtë kategori, 0.43 pikë indeksi.





FIGURA 24. SHKELJET LIGJORE (X7) PËR KOMUNAT E MESME

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT




# KOMUNAT E VOGLA

Edhe për vitin 2019, komunat e vogla në këtë nën-indikator kanë performuar më së miri, me një rezultat prej 0.76 pikë të indeksit. Ashtu siç është paraqitur në Figurën 25, komunat nga Hani i Elezit deri tek Kllokoti, ose gati gjysma e tyre (47%), kanë arritur rezultat maksimal prej 1. Kjo nënkupton që këto komuna nuk kanë pasur asnjë shkelje të gjykuar kundër tyre nga OSHP-ja.



**FIGURA 25. SHKELJET LIGJORE (X7) PËR KOMUNAT E VOGLA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT



# NËN-INDEKSI 8: PROCESI I PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT (X8)

**Procesi i planifikimit të prokurimit (x8)** kalkulohet përmes një procesi tre hapësh.

Në hapin e parë matet devijimi në mes të vlerës së parashikuar të kontratës dhe vlerës së dhënies së kontratës. Diferenca shprehet si përqindje duke e ndarë vlerën e devijimit me vlerën e parashikuar të kontratës ose me vlerën e dhënies së kontratës, varësisht se cila është më e vogël.

Në hapin e dytë, planifikimi i vlerës së kontratës vlerësohet për çdo kontratë, me formulën e mëposhtme:

$$\text{Vlerësimi} = 1 - \text{Devijimi (shprehur në përqindje)}$$

Në hapin e tretë dhe të fundit, përdoret formula e mëposhtme:

$$X8 = \frac{\sum(\text{vlera e dhënies së kontratës} \times \text{vlerësimi})}{\sum \text{vlera përfundimtare e kontratës}}$$

Kur bie fjala për efikasitetin në prokurimin publik, procesi i planifikimit padyshim luan një rol shumë të rëndësishëm. Planifikimi dhe realizimi i duhur u mundëson komunave të bëjnë shpërndarjen në mënyrën më efektive të të gjitha burimeve financiare dhe njerëzore. Për këtë qëllim, nën-indeksi Procesi i planifikimit të prokurimit (x8) krahason vlerën fillestare të kontratës të vendosur nga komuna në thirrje për tender (njoftimi për kontratë), me vlerën finale të dhënies së kontratës. Qëllimi i këtij nën-indeksi është që të ngris efikasitetin e planifikimit të komunave kur vendosin vlerën e paraparë të kontratës, duke i nxitur ato të zvogëlojnë devijimin ndërmjet vlerës fillestare të vendosur në njoftimin për kontratë, dhe asaj finale të dhënies së kontratës. Në përgjithësi, komunat kanë performuar mirë në këtë nën-indeks, me një performancë më të lartë se mesatarja e indeksit të përgjithshëm (0.70) dhe më e lartë krahasuar me rezultatin e vitit të

kaluar (0.78 pikë të indeksit). Komunat e vogla, performuan më së miri, me një rezultat prej 0.83. Ndërkohë, edhe komunat e mëdha dhe ato të mesme, krahasuar me vitin e kaluar kanë performuar më mirë; me një rezultat nga 0.67 në 0.75 pikë të indeksit për komunat e mëdha dhe 0.68 në 0.77 pikë të indeksit për komunat e mesme. Figura 26, paraqet performancën e komunave të mëdha në këtë nën-indeks. Komuna më efektive në planifikim në këtë kategori komunash është komuna e Gjilanit, me rezultat prej 0.85 pikë të indeksit. Ndërsa, komuna e Ferizajit e cila në vitin 2018 kishte rezultatin më të ulët (0.51 pikë të indeksit) në këtë kategori është ngritur për gjashtë vende për t'u radhitur si performuesi i dytë më i mirë në këtë kategori komunash. Për vitin 2019, komuna e Prizrenit ka rezultatin më të ulët (0.57 pikë të indeksit), duke nënkuptuar se kjo komunë ka diferencën më të madhe në mes të planifikimit dhe realizimit.



# KOMUNAT E MËDHA




FIGURA 26. PROCESI I PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT (X8) PËR KOMUNAT E MËDHA

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT




Rezultatet e x-indeksit nuk nënkuptojnë që procedurat e prokurimit të përdorura nga komunat janë ilegale. Nuk ka rregulla që përcaktojnë diferencën ndërmjet çmimit fillestar dhe atij të dhënies së kontratës. Megjithatë, sa më e vogël diferenca, aq më i lartë efikasiteti i autoriteteve kontraktuese në procesin e planifikimit.

0.1 0.2 0.3 0.4 0.5 0.6 0.7 0.8 0.9 1.0




## KOMUNAT E MESME

Nga komunat e mesme, Kamenica, ashtu siç është paraqitur në Figurën 27, është komuna me performancën më të mirë, e cila krahasuar me vitin 2018 është ngritur për trembëdhjetë (13) vende më lartë me një rezultat nga 0.53 në 0.90 pikë të indeksit. Performancë të mirë ka treguar gjithashtu edhe komuna e Deçanit, me një rezultat prej 0.87 pikë të indeksit. Në anën tjetër, e rënditur në fund të kësaj kategorie është komuna e Dragashit (e cila ka rënë për njëmbëdhjetë vende) dhe Malishevës me një rezultat të ulët të nën-indeksit prej 0.62 dhe 0.49 pikë indeksi, respektivisht.



**FIGURA 27. PROCESI I PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT (X8)  
PËR KOMUNAT E MESME**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT




# KOMUNAT E VOGLA

Komunat e vogla kanë performuar shumë mirë në këtë nën-indeks. Komuna e Zubin Potok dhe Leposaviqit janë në krye të tabelës me rezultat prej 0.98 pikë të indeksit për të dyja. Kjo nënkupton që këto komuna ishin tejet efikase në planifikim, dhe nuk kishin aspak diferencë ndërmjet procesit të planifikimit dhe realizimit.



**FIGURA 28. PROCESI I PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT (X8)  
PËR KOMUNAT E VOGLA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT





# NËN-INDEKSI 9: AFATI KOHOR (X9)

**Afati kohor (x9)** kalkulohet si shuma e të gjitha njoftimeve për kontratë që kanë përdorur afatin e përshpejtuar, pjesëtuar me numrin total të njoftimeve për kontratë. Formula për të llogaritur indikatorin x9 është:

$$x9 = 1 - \left( \frac{\text{Nr. i njoftimeve për kontratë me afat të përshpejtur}}{\text{Nr. i njoftimeve për kontratë}} \right)^{1/2}$$

Ky nën-indeks është krijuar me qëllim të parandalimit të komunave nga përdorimi i procedurave të përshpejtuara kohore. Përdorimi i shpeshtë i këtyre procedurave, redukton kohën në dispozicion të operatorëve ekonomikë për përgaditjen e tenderëve, duke dëmtuar kështu edhe konkurrencën ndërmjet tyre.

Varësisht nga lloji, madhësia dhe procedura e Njoftimit për Kontratë, përdorimi i afatit kohor është i përcaktuar qartë në Ligjin për Për Prokurim Publik. Neni 44, i Ligjit të Kosovës për Prokurim Publik përcakton se çfarëdo afati kohor i caktuar nga autoriteti kontraktues për pranimin e tenderëve duhet të jetë i mjaftueshëm për t'i dhënë operatorëve të interesuar ekonomik kohë të mjaftueshme për të përgaditur dhe dorëzuar kërkesën. Megjithatë, Neni 46, po ashtu përcakton që autoritetet kontraktuese, në këtë rast komunat, janë të lejuara të përdorin rregulla dhe procedura të veçanta kohore, si Afate të Përshpejtuara Kohore, në rastet e urgjencave apo rrethana tjera të ngjashme.

Komunat kanë performuar mbi mesataren e x-indeksit të përgjithshëm, prej 0.70 pikë indeksi. Mesatarja e rezulttit në këtë nën-indeks është 0.62 pikë indeksi. Komunat e mëdha janë komunat që kanë performuar më së miri, me një rezultat prej 65 pikë të indeksit; të ndjekura nga komunat e mesme (0.61 pikë të indeksit). Në ndërkohë, komunat e vogla kanë përdorur më së shpeshti këtë procedurë, prandaj dhe kanë një rezultat të ulët prej 0.59 pikë të indeksit.

Nga komunat e mëdha, siç është paraqitur në Figurën 28, komuna e Prizrenit ka rezultatin më të lartë, prej 0.83 pikë të indeksit. Nga gjithsej 244 njoftime për kontratë sa ka pasur komuna, në vetëm 7 raste (apo 3%) ka përdorur afatin e përshpejtuar kohor. Në anën tjetër, nga kategoria e komunave të mëdha, Mitrovica edhe për këtë vit është komuna që ka përdorur më së shpeshti këtë procedurë, dhe si rezultat renditet në fund të kësaj kategorie komunash, me rezultat prej 0.35 pikë të indeksit. Nga gjithsej 60 njoftime për kontratë, në 25 prej tyre, ose 42% të rasteve, komuna e Mitrovicës ka përdorur procedurën e përshpejtitimit kohor.

## KOMUNAT E MËDHA




FIGURA 29. AFATI KOHOR (X9) PËR KOMUNAT E MËDHA

BURIMI: VLERËSIMI ORIGINAL I AUTORIT



Rezultatet e x-indeksit nuk nënkuptojnë që procedurat e prokurimit të përdorura nga komunat janë ilegale. Përdorimi i afatit të përshpejtuar kohor është i lejuar me Nenin 44. të Ligjit të Kosovës për Prokurim Publik, i cili rekomandon përdorimin e këtij afati kohor në raste të vecanta sic janë emergjencat dhe rastet e tjera. Megjithatë, një përdorim i shpeshtë i këtij afati dëmton konkurrencën.

0.1 0.2 0.3 0.4 0.5 0.6 0.7 0.8 0.9 1.0




## KOMUNAT E MESME

Siç paraqitet në Figurën 30, Kaçaniku është komuna që ka performuar më së miri në këtë nën-indeks, me një rezultat prej 0.86 pikëve të indeksit. Rezultate shqetësuese ka treguar se komuna e Glllogocvit e cila në vitin 2018 ka qenë i renditur si performuesi i dytë më i mirë në këtë kategori komunash. Kjo komunë ka rënë për dymbëdhjetë vende më poshtë, krahasuar me vitin e kaluar, me rezultat nga 0.82 në 50 pikë të indeksit. Ndërkohë, komuna e Deçanit ka përdorur më së shpeshti këtë procedurë, dhe si rezultat është renditur në fund të kësaj kategorie, me një mesatare prej 0.44 pikëve të indeksit.



**FIGURA 30. AFATI KOHOR (X9) PËR KOMUNAT E MESME**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT




# KOMUNAT E VOGLA

Komunat e vogla kanë performancën më të ulët në këtë nën-indikator, me një rezultat prej 0.59 pikë të indeksit (e cila krahasuar me rezultatin e vitit 2018 është më e lartë). Hani i Elezit dhe Juniku kanë performancën më të mirë nga të gjitha komunat në këtë kategori, me një rezultat prej 0.82 dhe 0.77 pikë të indeksit, respektivisht. Gjithsesi, në anën tjetër, komunat si ajo e Zveçanit (0.45), Shtimes (0.43) dhe Zubin Potokut (0.31) janë performuesit më të dobët në këtë lloj kategori komunash.



**FIGURA 31. AFATI KOHOR (X9) PËR KOMUNAT E VOGLA**

BURIMI: VLERËSIMI ORIGJINAL I AUTORIT





**Organizatat e shoqërisë civile dhe mediat duhet të jenë më aktive në monitorimin dhe sinjalizimin e keqpërdorimeve në procesin e prokurimit publik, si dhe të dalin me rekomandime për përmirësimin e sistemit.**



# 5

## METODOLOGJIA

### Ndërtimi i indikatorëve

Metodologjia e 'x-indeks' mbështetet në një metodologji tashmë të krijuar dhe të kontekstualizuar që t'i përbrendësojë specifikat e Kosovës. Kjo metodologji është zhvilluar në atë mënyrë që synon të përfshijë të gjitha çështjet kryesore që kanë të bëjnë me prokurimin publik në nivel lokal në Kosovë. Në mënyrë që ti klasifikojë dhe ti grupojë komunat në tri grupe (të mëdha, të mesme dhe të vogla), buxheti dhe numri i stafit të komunave është marrë parasysh. Një peshë e barabartë i është dhënë buxhetit dhe numrit të stafit të komunave. Të dhënat rreth buxhetit dhe stafit të komunave, janë marrë nga Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 (Ligji Nr. 06/L-20).

Metodologjia vlerësuese bazohet në nëntë nën-indeks të pjeshme të monitorimit, ku secili prej tyre përshkruan një çështje të vecantë të prokurimit publik. Hulumtuesit e Institutit Riinvest kanë zhvilluar një model statistikor dhe mbledhën të dhëna nga platforma elektronike 'e-prokurimi' për një periudhë dymbëdhjetë mujore (janar-dhjetor 2018). Të dhënat e kontratatave u grumbulluan nga platforma 'e-prokurimi', veçanërisht nga Njoftimet për Kontratë dhe Njoftimet për Dhënie të Kontratave. Burime të tjera të të dhënave përfshijnë OSHP (marrja e vendimeve bazuar në mbikqyrjen e ligjshmërisë së praktikave të prokurimit të autoriteteve kontraktuese); ARBK (Emri i operatorit ekonomik); dhe Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018. Të dhënat, për mbledhjen e të cilave është e nevojshme qasja në kontratë, janë marrë nga faqet ueb-faqet e komunave.

## X 1 Prokurimi publik si pjesëmarrës në totalin e blerjeve të komunës

mat raportin ndërmjet të gjitha vlerjeve që kryen autoriteti kontraktues ose komuna dhe blerjeve që bën përmes prokurimit publik. Indikatorit krahason vlerën totale të kontratave të komunave të publikuara në platformën 'e-prokurimi' me vëllimin total të kostove operacionale të kontrollueshme. Kostot operative të kontrollueshme përkufizohen si shuma e artikujve të zgjedhur të kostove që varen nga menaxhimi i autoritetit kontraktues, në këtë rast menaxhimi i komunave. Në modelin tonë, kostot operacionale të kontrollueshme përfshijë: mallrat dhe shërbimet, dhe shpenzimet kapitale. Pagat dhe mëditjet; subvencionet dhe transferet si dhe shërbimet janë përjashtuar, pasi ato janë shpenzime që nuk menaxhohen nga komunat. Të dhënat në lidhje me shpenzimet e lartpërmendura janë mbledhur nga "Raporti financiar vjetor" i publikuar nga Ministria e Financave. Formula për llogaritjen e "prokurimit publik si pjesë e blerjeve totale" është si më poshtë:

$$x1 = \sqrt{\frac{\text{vlera e kontratave të prokurimit publik}}{\text{vlera e kostove operative të kontrollueshme}}}$$

Për shembull, në komunën e Prishtinës, shuma e përgjithshme e kontratave të prokurimit publik është 29,247,231.54€, ndërsa vlera e shpenzimeve operative të kontrollueshme është 34,429,154.00€. Nën-indeksi është vlerësuar me rezultat 0.92 pikë indeksi.

## X 2 Kontraktimi konkurrues

mat vlerën dhe numrin e kontratave me procedurë të negociuar pa publikim (PNnP), në raport me vlerën totale dhe numrin total të kontratave. Në mënyrë që të bëhet matja e vlerës dhe numrit të kontratave të dhëna, peshë e barabartë i është dhënë të dyjave (siç vërehet edhe në formulë). Vlera e ulët e këtij indikator tregon se komuna gjatë blerjeve përmes prokurimit publik e shfrytëzon në masë të konsiderueshme procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe anasjelltas. Formula për llogaritjen e indikatorit të "Kontraktimit Konkurrues", është si më poshtë:

$$x2 = \left\{ \left[ \left( 1 - \frac{\text{vlera e kontratave me procedurë të negociuar pa publikim (PNpN)}}{\text{vlera totale e kontratave}} \right) + \left( 1 - \frac{\text{numri i kontratave me procedurë të negociuar pa publikim (PNpN)}}{\text{numri total i kontratave}} \right) \right] / 2 \right\}^4$$

Për shembull, në komunën e Prishtinës, vlera totale e kontratave të dhëna përmes PNpN është 2,780,632€, ndërkaq vlera totale e kontratave të komunës është 29,247,231.54€. Numri i kontratave të dhëna me procedurë të negociuar pa publikim është 39, ndërsa totali i kontratave nga komunat është 191. Nën-indeksi është vlerësuar me rezultat mesatar prej 0.52 pikë të indeksit.

## X 3 Sjellje e qëndrueshme

ky indikator llogaritet në bazë të të gjitha njoftimeve të kontratave të lëshuara nga autoriteti përkatës kontraktues të marra nga 'e-prokurimi'. Rezultati për secilën kontratë të publikuar vlerësohet si më poshtë:

- Një rezultat prej 1 i jepet një kontrate të dhënë siç duhet pa ndonjë njoftim korigjimi.
- Një rezultat prej 0.75 është dhënë për kontratat me një njoftim korigjimi të bashkangjitur.

- 0.5 pikë i jepet kontratave me dy njoftime korigjimi të bashkangjitura.
- Një vlerësim prej 0.25 i jepet kontratave me tre njoftime korigjimi të bashkangjitura.
- Vlerësimi me 0 u jepet kontratave me katër ose më shumë njoftime korigjimi, për anulimin e procedurave të tenderit, ose në rastet kur nuk është dhënë asnjë kontratë (d.m.th. kur nuk ka njoftim për dhënie të kontratës dhe as njoftim për anulim në “e-prokurimi”).

Formula për llogaritjen e indikatorit “Sjellje e qëndrueshme” është si më poshtë:

$$x3 = \frac{\sum \text{rezultati i kontratës}}{\text{numrin e kontratave}}$$

Për shembull, në komunën e Prishtinës, kontratave me një njoftim korigjimi ose kontratave të anuluar, u është dhënë një rezultat në mes të 0 dhe 0.75 pikëve. Pjesës tjetër të kontratave u është dhënë rezultati prej 1 pikë. Rezultati i përgjithshëm i kontratave nga vlerësimi sipas rregullës që u përmend më lart është 152.72, ndërsa numri i njoftimeve për kontratë është 190. Nën-indeksi është vlerësuar me rezultat mesatar prej 0.80 pikë të indeksit.

## X 4 Koncentrimi i fituesit

matet si vlera dhe numri i të gjitha kontratave të dhëna për cdo ofertues individual, pjesëtuar me vlerën totale dhe numrin total të të gjitha kontratave të dhëna nga autoriteti kontraktues; kjo llogaritje është bërë për secilin ofertues të suksesshëm dhe rezultatet janë përmbledhur. Formula për llogaritjet e këtij nën-indeksi është si më poshtë:

$$x4 = \left\{ \left[ 1 - \sum \left( \frac{\text{vlera e kontratave të dhëna secilit ofertues}}{\text{vlera totale e kontratave}} \right)^2 \right] + \left[ 1 - \sum \left( \frac{\text{numri i kontratave të dhëna secilit ofertues}}{\text{numri total i kontratave}} \right)^2 \right] \right\} / 2$$

Kjo llogaritje bëhet duke përdorur indeksin standard ‘Herfidahl’ për matjen e përqendrimit të furnizuesit, përshtatur për qëllime të kontratave të prokurimit publik. Indeksi që rezulton ngrihet në katrorë në mënyrë që të theksohet dallimi mes autoriteteve kontraktuese me vlerësim të lartë dhe të ulët.

- Nëse të gjitha kontratat e autoritetit kontraktues i janë dhënë një kontraktori të vetëm, pjesa e tij është e barabartë me 1 dhe vlera e indikatorit është 0.
- Nëse dy kontraktues kanë furnizuar gjysmën e kontratave të autoritetit secila, atëherë vlera e indikatorit do të jetë 0.25.
- Në qoftë se tre kontraktuesve u janë dhënë 50%, 25% dhe 25% të të gjitha kontratave të autoritetit, vlera e indikatorit është e barabartë  $(1 - (0.5^2 + 0.25^2 + 0.25^2))^2 = 0.39$ .
- Nëse dhjetë kontraktues ishin po aq të suksesshëm në fitimin e procedurave të tenderimit me autoritetin e dhënë, vlera e indikatorëve është 0.81.

Për shembull, në komunën e Prishtinës, katrori i vlerës totale të kontratave të dhëna për secilin ofertues ne raport me katrotin e vlerës totale te kontratave ishte 0.96 pikë të indeksit, ndërsa katrori i numrit total të kontratave të dhëna për secilin ofertues në raport me katrorin e numrit total te kontratave është 0.98 pikë të indeksit. Nën- indeksi është vlerësuar me një rezultat mesatar prej 0.97 pikë të indeksit.

## X 5 Pjesëmarrja e ofertuesit

Ky indikator llogaritet përmes një procesi dy hapësh. Në hapin e parë, niveli i konkurrencës vlerësohet për secilën kontratë dhe pastaj nxirret mesatarja për të gjitha kontratat për të dhënë një indikator të pjesshëm "k" tek autoriteti i caktuar kontraktues. Nën-indikator "k" krahason numrin e tenderëve të dorëzuar për një thirrje të caktuar për tender, me mesataren e numrit të tenderëve për llojin e kontratës. Në këtë model, llojet e kontratave që janë llogaritur janë: kontratat e furnizimit publik, kontratat e shërbimeve publike dhe kontratat e punës. Formula për llogaritjen e indikatorit të pjesshëm "k" është siç paraqitet më poshtë:

$$k = 0.5 + \frac{\text{tenderët e dorëzuar për kontrataë-mesatarja e tenderëve për llojin e kontratës}(tenderët e dorëzuar)}{\text{mesatarja e tenderëve për llojin e kontratës} (tenderët e dorëzuar)}$$

Hapi i dytë në llogaritjen tonë është llogaritja e indikatorit agregat si shumë e ponderuar e indikatorëve k në të gjitha kontratat e dhëna nga autoriteti përkatës kontraktues. Çmimi i dhënë i çdo kontrate përdoret si pesha e tij, me qëllim të theksimit të rezultateve të indikatorëve për kontratat e mëdha.

$$x5 = \frac{\sum \text{vlera e kontratës} * k}{\text{vlera totale e kontratave}}$$

Për shembull, në komunën e Prishtinës, vlera e kontratës shumëzuar me koeficientin "k" është 21,269,273.91€, ndërsa vlera totale e kontratave është 29,247,231.54€. Nën-indeksi është vlerësuar me një rezultat mesatar prej 0.73 pikë të indeksit.

## X 6 Mjetet pro-konkurrencës

tregon se deri në çfarë mase autoriteti kontraktues (komuna) përdor mënyrat opcionale që ndikojnë në rritjen e konkurrencës si:

- Kontratat e ndara në pjesë- u mundëson autoriteteve kontraktuese që të sigurojnë konkurrencë maksimale për çdo element të prokurimit. Ky instrument gjithashtu lehtëson qasjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në kontratat publike, pasi zvogëlon kërkesat e kualifikimit dha ndan punën më të thjeshtë që mund të kryhet nga një gamë më e gjerë ofertuesish nga detyra më të specializuara.
- Kontratat të cilat për kriter të dhënies e kanë kualitetin- ky nën-indikator synon të përmisojë konkurrencën mbi një konkurrencë çmimesh me të mirën më të lirë dhe me cilësi të ulët.

Në përpjekjet e vazhdueshme për të nxitur konkurrencën, indikator "Mjetet pro-konkurrencës" i shpërblen komunat për zbatimin e këtyre aktiviteteve shtesë, të cilat shkojnë përtej detyrimeve ligjore dhe mbështesin një mjedis konkurrues në prokurimin publik. Nuk do të kishte kuptim të kërkohej nga komunat që këto mjete të përdoshin në çdo kontratë si dëshmi e praktikave më të mira, pasi që këto mjete nuk janë të përshtatshme në shumë raste. Prandaj, çdo komune që përdor këto

mjete, në më shumë se 25% të rasteve i është dhënë vlerësimi maksimal. Në llogaritjen e vlerës së indikatorit, çdo pjesë është shumëzuar me katër, por e kufizuar në vlerën maksimale 1. Kjo nënkuptoj që një autoritet kontraktues që i ndan të gjitha kontratat në pjesë, por vazhdon afatin e aplikimit, i jepet vlera 1/3. Për llogaritjen së indikatorit, mirren parasysh:

- Pjesa e kontratave të ndara në pjesë, nga numri total i kontratave
- Pjesa e kontratave të cilat për kriter të dhënies kanë kualitetin, nga numri total i kontratave

Formula e mëposhtme përdoret për të llogaritur këtë indikatorë:

$$x6 = \left( \frac{4x(nr. i kontratave të ndara në pjesë + nr. i kontratave të cilat për kriter kanë kualitetin)}{2x nr. i kontratave} \right)^{1/2}$$

Për shembull, në komunën e Prishtinës, nga gjithsej 164 njoftime për kontratë sa ka pasur kjo komunë, 22 prej tyre janë ndarë në pjesë dhe vetëm 1 prej tyre përdorën kualitetin si kriter për dhënie të kontratës. Nën-indeksi është vlerësuar me një rezultat mesatar prej 0.53 pikë të indeksit.

## X 7 Shkeljet ligjore

ky indikator matet përmes shkeljeve ligjore gjatë procedurave të prokurimit nga ana e autoritetit kontraktues (komunës), të ndarë me numrin e njoftimeve për dhënie të kontratave nga komuna. Pra, ky indikator pasqyron numrin e rasteve me shkelje ligjore të gjykuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), i cili është organi i autorizuar për të vlerësuar ligjshmërinë e praktikave të prokurimit publik të kontraktuesve. Për të vlerësuar këtë indikator, shfletohen të gjitha vendimet e OSHP-së gjatë gjithë periudhës Janar- Dhjetor 2018 në mënyrë që të kuptohet se a janë bërë shkeljet ligjore dhe a mund të konsid-erohen serioze. Formula e përdorur për të llogaritur këtë indikator është si më poshtë:

$$x7 = 1 - \left( \frac{\text{numri i rasteve të shkeljeve ligjore gjatë procedurave të prokurimit publik}}{\text{numri i kontratave}} \right)^{1/4}$$

Për shembull, në komunën e Pejës, nga gjithsej 164 njoftime për kontratë, 33 prej tyre kanë pasur shkelje ligjore. Nën-indeksi është vlerësuar me rezultat mesatar prej 0.33 pikë të indeksit.

## X 8 Procesi i planifikimit të prokurimit

evlerëson procesin e planifikimit të prokurimit të komunave, duke krahasuar vlerën fillestare të kontratës të caktuar nga komuna të publikuar në thirrjen për tender, me vlerën e dhënies së kontratës. Qëllimi i këtij nën-indeksi është që të ngris efikasitetin e planifikimit të komunave kur vendosin vlerën e paraparë të kontratës, duke i nxitur ato të zvogëlojnë devijimin ndërmjet vlerës fillestare të vendosur në njoftimin për kontratë, dhe asaj finale të dhënies së kontratës. Ky indikator matet përmes një procesi tre hapësh.

Në hapin e parë, matet devijimi në mes të vlerës së parashikuar të kontratës dhe vlerës së dhënies së kontratës. Ky devijimi matet duke gjetur diferencën midis vlerës së parashikuar të kontratës dhe vlerës së dhënies së kontratës dhe shprehet si përqindje duke e ndarë vlerën e devijimit me vlerën e parashikuar të kontratës ose me vlerën e dhënies së kontratës, varësisht se cila është më e vogël. Kjo llogaritje kryhet me qëllim të vlerësimit të rasteve kur vlera e dhënies së kontratës është më e lartë se vlera e parashikuar e kontratës, ose e kundërta. Në rastet kur vlera e dhënies së kontratës është dy herë më e vogël osë më e lartë se vlera e parashikuar e kontratës, devijimi i shprehur në përqindje merr një vlerë 100% në të dyja rastet.

Në hapin e dytë, planifikimi i vlerës së kontratës vlerësohet për çdo kontratë, me formulën e mëposhtme:

$$\text{Vlerësimi} = 1 - \text{Devijimi (shprehur në përqindje)}$$

Në hapin e tretë dhe të fundit, përdoret formula e mëposhtme:

$$X8 = \frac{\sum(\text{vlera e dhënies së kontratës} \times \text{vlerësimi})}{\sum \text{vlera përfundimtare e kontratës}}$$

Për shembull, në komunën e Prishtinës, vlera përfundimtare e kontratave x vlerësimi është 21,019,627.27 € ndërsa vlera përfundimtare e kontratave është 26,384,731.54€. Vlera e nën-indeksit është mesatarisht 0.80 pikë të indeksit.

## X 9 Afati kohor

mat se sa shpesh autoriteti kontraktues (komuna) e përdor afatin e përshpejtuar duke gjetur shumën e njoftimeve për kontratë me afat të përshpejtuar, dhe duke e pjesëtuar atë me numrin e përgjithshëm të njoftimeve për kontratë. Formula për ta llogaritur indikatorin x9 është:

$$x9 = 1 - \left( \frac{\text{Nr. i njoftimeve për kontratë me afat të përshpejtuar}}{\text{Nr. i njoftimeve për kontratë}} \right)^{1/2}$$

Për shembull, në komunën e Prishtinës, nga gjithsej 190 kontrata të dhëna sa ka pasur kjo komunë, në 31 prej tyre është përdorur procedura e afatit të përshpejtuar kohor. Nën-indeksi është vlerësuar me një rezultat mesatar prej 0.59 pikë të indeksit.

Në fund, 9 indikatorët e shpjeguar më sipër, kombinohen për të prodhuar një vlerë të vetme të x-indeksit duke e përdorur një mesatare të ponderuar:

$$xindex = \frac{x_1 + x_2 + x_3 + x_4 + x_5 + x_6 + x_7 + x_8 + x_9}{9}$$

Ku X është vlera finale e x-indeksit, dhe x1 deri në x9 janë vlerat e indikatorëve të numëruar sipas listës së më sipërme (pason llogaritja e detajuar e indikatorëve). Secili prej indikatorëve është i shkallëzuar në mes 0 dhe 100, dhe kështu ata kanë peshë të barabartë.







